



Nr. 59prot  
Dt. 16/08/2018

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



V E N D I M

Nr. 4      Datë 14. 08. 2018

**“MIRATIM NË PARIM PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “DIZDARI ENERGJI-AG” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, të nenit 50, pika 2, të ligjit nr.6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr.111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika1/ c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni”, për paisjen me autorizim(miratim ne parim) të subjektit “DIZDARI ENERGJI-AG” SH.P.K., me propozim të A.B.U Drin- Bunë dhe oponentës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

V e n d o s i:

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit “**DIZDARI ENERGJI-AG**” SH.P.K me administrator Z. Edison DODA, për përdorim të burimit ujor, **Përroi i Lashkizes dhe Shehut**, degë të Lumit Drin i Zi për prodhim energjie elektrike në fshatin Zall-Dardhë, Njësia Administrative Zall-Dardhë, Bashkia Dibër, Qarku Dibër .

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti, HEC ZALLDARDHA do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës së marrjes nr.1:  $X_1 - 44\ 44\ 300$  ;  $Y_1 - 46\ 31\ 190$  ;  $Z_1 - +448$  m

Koordinatat e veprës së marrjes nr.2:  $X_2 - 44\ 43\ 600$  ;  $Y_2 - 46\ 30\ 350$  ;  $Z_2 - +448$  m

Koordinatat e godinës së centralit:  $X - 44\ 44\ 630$  ;  $Y - 46\ 30\ 160$  ;  $Z - +380.5$  m

Koordinatat e pikes së shkarkimit :  $X - 44\ 44\ 630$  ;  $Y - 46\ 30\ 160$  ;  $Z - +380.5$  m

Prurja mesatare vjetore e burimeve:  $Q_1 \text{ mes} = 0.320 \text{ m}^3/\text{sek}$ ;  $Q_2 \text{ mes} = 0.782 \text{ m}^3/\text{sek}$

Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti:  $Q \text{ llog} = 0.990 \text{ m}^3/\text{sek}$ ;

Prurja ekologjike:  $Q \text{ ekol} = 0.272 \text{ m}^3/\text{sek}$ ;

Prurja që shkarkohet:  $Q = 0.990 \text{ m}^3/\text{sek}$ .

2- Autorizimi(miratimi ne parim) i përdorimit të burimit ujor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3-Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

**PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË**

SEKRETARE

Raimonda GURI



KRYETARI

Ceska MLLJA

